# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-456847**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Greqia jep 10 mijë € për të jetuar në zonat e Çamërisë |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1392617.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 07:04:34 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 19 shtator 2026, 06:56:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 19 shtator 2026, 06:55:00 UTC → 19 shtator 2026, 06:57:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `166b11c47447d33b6f2565d1a4a5213a9a2ee379583dd9ac95f3cac266be73fa` |
| TEKSTI | `41749b88391b9bfd135a8a4a4e418de61df3d43d0901f857edeb110d459529c2` |
| PAMJA | `5402a7bef8a337fee1daa8c84017480b388064c1ae3247f8fe850e2279045a11` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `8e80eaf98bb183315046681bd0fbd5c907b1fefc8db0595595fd370da42168cc` |
| E MËPARSHMJA | `47d295d133f728eaf44c14d8e1ef0e7d226eff2939eca6cf47465d256eb9a24e` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/8e80eaf98bb183315046681bd0fbd5c907b1fefc8db0595595fd370da42168cc`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Greqia jep 10 mijë € për të jetuar në zonat e Çamërisë

Shkruar nga: S. H | Publikuar më: 19.09.2026, 08:56

Share Share



Greqia po përgatit një program për ripopullimin e zonave të banuara përgjatë kufirit me Shqipërinë, me një paketë financiare deri në 10 mijë euro për familje dhe paradhënie prej 50%. Sipas mediave greke, programi përfshin bashkitë e Sulit dhe Filatit në Thesproti, si dhe Pogonin e Konicës pranë Janinës, zona që historikisht kanë pasur edhe popullsi çame. Aplikimet për skemën pritet të nisin në tetor.

Përveç mbështetjes financiare, plani parashikon investime në infrastrukturën e zonave të izoluara malore, përfshirë kopshte, shkolla dhe qendra shëndetësore, me synimin për të frenuar largimin e banorëve drejt qyteteve të mëdha. Përfitues mund të jenë personat që jetojnë dhe punojnë ligjërisht në Greqi, përfshirë nomadët digjitalë, ndërsa është hequr kushti për një parakontratë pune. Programi do të shtrihet edhe në zona kufitare me Maqedoninë e Veriut, Bullgarinë dhe Turqinë.

Nisma është pjesë e një politike më të gjerë të Athinës për përballimin e rënies së popullsisë në zonat periferike. Programi fillestar u aplikua në ishullin Kastellorizo, ku Greqia synon të ruajë një prani të qëndrueshme civile dhe ushtarake, në një zonë të ndjeshme për shkak të tensioneve me Turqinë dhe interesave strategjike në Mesdheun Lindor.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat

ARTIKULL JOETIK?

TË NGJASHME

Më të fundit




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.